



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 6228 prot.

Ballsh, më 31.12.2024

VENDIM

Nr. 71, datë 31.12.2024

**“PËR
DHËNIEN E NJË NDIHME TË MENJËHERSHME FINANCIARE PËR PUNONJËSIT
MBËSHTETËS TË BASHKISË MALLAKASTËR”**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo –territoriale të njësisve të qeverisjes vendore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ndryshuar, të ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 35/2023 “për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të punësuarve në institucionet e administratës publike, VKB nr.64, datë 21.12.2023” Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Mallakastër dhe Buxhetin e Vitit 2024,

VENDOSI:

I. Dhënie e një ndihme të menjëhershme financiare , në masën 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, punonjësve si më poshtë :

- Punonjës mbështetës në Administratë dhe Sektorë në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike.
- Punonjësve mbështetës në Çerdhen Ballsh (sanitare, kuzhiniere, rrobalarëse)
- Punonjësve mbështetës në Institucionet Arsimore dhe QKF (sanitare, roje, sekretare)
- Punonjësve mbështetës në Administratën dhe Njësinë Administrative Fratar
- Punonjësve mbështetës në Administratën e Bashkisë Mallakastër (sekretar, arkëtar, topograf, magazinier, punonjës biblioteke, punonjës informacioni, etj)

- Punonjësve të Sektorit të MZSH-së
- Punonjësve të Policisë Bashkiake.

II. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga Buxheti i Bashkisë Mallakastër.

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

